



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I ZGJEDHJEVE**

**I. Kryetari i Akademisë**  
**(Kriteret e dhe procedurat)**

Mbështetur: **1.** Ligjit nr. 9655 datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave të Rrepublicës së Shqipërisë*, neni 11, *Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë* (ndryshuar me Ligjin nr. 9853, datë 26.12.2007, neni 7); **2.** *Statutit organik të saj*, neni 17 dhe neni 18; **3.** *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*;

Duke qenë se funksioni i Kryetarit është vakant që nga muaji shtator 2017;

Përmes kësaj thirrjeje publike ftohen për konkurrim anëtarët e Asamblesë me titullin *akademik* ose *akademik i përhershëm*.

**I. Kërkesa për dokumentacion:**

Sipas procedurës së parashikuar në Statut, kandidatët duhet të paraqesin pranë Akademisë së Shkencave:

- 1.** Kërkesë vetjake për aplikim drejtuar Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
- 2.** Fotokopje të kartës së identitetit / pasaportës;
- 3.** Curriculum Vitae;
- 4.** Listë të studimeve të botuara (monografi, artikuj);
- 5.** Platformë për drejtimin e Akademisë së Shkencave gjatë mandatit të tij;
- 6.** Formular aplikimi për informim për zyrtarët para emërimit / zgjedhjes në poste të larta (sipas nenit 29, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 45/2015 *Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*);
- 7.** Formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit konfirmohet mosekzistenca e shkaqeve penguese për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar,

sipas Ligjit nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*. Formulari gjendet në webin e Akademisë së Shkencave, në linkun e mëposhtëm:

<http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

## **II. Kalendar i procesit zgjedhor:**

1. Pranimi i dokumentacionit për konkurrim është nga data 10 prill 2019 deri më 10 maj 2019.
2. Procesi i verifikimit në rrugë institucionale të garancive ligjore sipas pikave 6 dhe 7, nga data 10 deri më 15 maj 2018;
3. Mbledhja e Asamblesë për votimin e kandidaturave do të zhvillohet më 24 maj 2019, ora 10.00, në sallën *Aleks Buda*.
4. Para votimit kandidatët do të paraqesin projektin e tyre për drejtimin e institucionit. Koha në dispozicion të çdo kandidati është 15 minuta. Anëtarët e Asamblesë kanë të drejtë të bëjnë pyetje rreth projekteve.

## **III. Procedura e konkurrimit dhe e votimit:**

1. Kandidatë për funksionin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave mund të jenë *anëtarët e rregullt dhe anëtarët e përhershëm* të Asamblesë.
2. Zgjedhja e Kryetarit bëhet me votim të fshehtë në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë, pa debat.
3. Shpallet i zgjedhur në funksionin e Kryetarit kandidati që fiton shumicën e absolute (50 për qind +1) të votave të të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
5. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet dhe fitues shpallet kandidati me 50 për qind + 1 të anëtarëve Asamblesë të pranishëm në votim.
6. Mandati në detyrë është 4-vjeçar dhe fillon ditën e zgjedhjes nga Asambleja.
7. Kandidati fitues dërgohet për dekretim nga Presidenti i Republikës sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni **92**, gërma **g**.

**IV. Detyrat e Kryetarit të Akademisë, sipas rregullores së brendshme të Akademisë së Shkencave, kreu III, *Funksionet drejtuese*, neni 7, janë:**

**1.** Kryetari është titullar i Akademisë së Shkencave, i zgjedhur nga Asambleja dhe i dekretuar nga Presidenti i Republikës.

**2.** Kryetari ushtron përgjegjësi të tjera të parashikuara në Statut dhe në rregullore *për shkak të detyrës*.

**3.** Kryetari i ushtron detyrat dhe funksionet e tij të përcaktuara: **1.** Në Ligjin *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, nr. 9655, datë 11.12.2006, ndryshuar; **2.** Në Statutin e Akademisë së Shkencave dhe në rregullore:

- Përfaqëson Akademinë e Shkencave në marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe të shteteve të tjera;

- Drejton organizmat e Akademisë dhe ndjek veprimtarinë e tyre;

- Mban lidhje me organet e larta shtetërore dhe organizma të tjera dhe përfaqëson Akademinë në to;

- Përfaqëson Akademinë në të gjitha marrëdhëniet e saj me institucionet e vendit dhe me institucionet analoge jashtë vendit;

- Thërret dhe drejton mbledhjen e Asamblesë së Akademisë, Këshillit Ekzekutiv dhe këshillit të botimeve;

- Për mbarëvajtjen e punës, Kryetari i Akademisë shprehet me vendime për të gjitha çështjet që kërkojnë akt nënligor;

- Miraton kalendarin vjetor të veprimtarive shkencore të institucionit;

- Miraton planin e botimeve;

- Kryetari i Akademisë në gjithë veprimtarinë e tij dhe ushtrimin e funksionit ndihmohet nga Zëvendëskryetari dhe sekretari shkencor. Në rast mungese, ai autorizon njërin prej tyre për ta zëvendësuar përkohësisht në funksionet e tij;

- Kryen veprimtari kërkimore-shkencore vetjake.